



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 177 Prot.

Tiranë, më 31.01.2024

V E N D I M
Nr. 18, Datë 31.01 2024

PËR
“MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË KONTROLLIN E LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2024”

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” të ndryshuar, neni 18, ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 25, si dhe Vendimit nr. 19, datë 31.01.2022, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit Vjetor të Pranimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit me numër total 24 vende vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2024 në pozicione pjesë e shërbimit civil.
2. Vendet vakante janë përkatësisht:
 - Nëpunës Civil në nivelet drejtuese 7 vende;
 - Nëpunës civil pjesë e trupës audituese dhe drejtorive mbështetëse 17 vende.
3. Referuar juridiksionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit formimi dhe edukimi i individëve që do të rekrutohen nuk do të ketë kufizime por kryesisht do të përfshijë drejtimet si vijon:
 - Shkenca juridike;
 - Shkenca ekonomike;
 - Shkenca ekonomike/juridike;
 - Shkenca kompjuterike;
 - Shkenca shoqërore;
 - Shkenca sociale;
 - Histori-filologji;
 - Veterinari;
 - Agronomi;
 - Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
 - Kimi;
 - Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;

- Shkenca inxhinierike;
 - Arkitekturë;
 - Arkeologji dhe restaurime;
 - Gjeodezi;
 - Shkenca ekzakte;
 - Shkenca edukimi;
 - Etj..
4. Procedurat për plotësimin e këtyre vendeve vakante do të zhvillohen në vijimësi duke iu referuar kuadrit ligjor për nëpunësin civil, ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore.
 5. Njoftimet e detajuara për vendet vakante do të publikohen rast pas rasti në faqen e internetit në KLSH <https://www.klsh.org.al/> dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit <https://www.puna.gov.al/>.
 6. Të rekrutuarit nëpërmjet procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për nëpunësin civil do të emërohen në departamentet e auditimit dhe drejtoritë mbështetëse rast pas rasti në varësi të politikave të brendshme për menaxhimin e burimeve njerëzore të KLSH-së, si dhe nevojave që ka secili departament dhe drejtori për realizimin e planit vjetor të auditimeve dhe përmbushjes së detyrave funksionale.

K R Y E T A R

Arben Shehu

